



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 748
Datë: 13/4/2022

Në mbështetje të nenit 23 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në pajtim me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikës së Kosovës dhe nenin 28, parag. 4 të Rregullores me nr. prot. 771, datë 6.3.2020 për rregullat dhe procedurat për zgjedhjet e përgjithshme të personelit akademik dhe jo-akademik në nivel të përfaqësimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Këshilli Drejtues i UP-së, në mbledhjen e mbajtur me 7.4.2022, miratoi këtë:

RREGULLORE

Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 771, datë 6.3.2020 për rregullat dhe procedurat për zgjedhjet e përgjithshme të personelit akademik dhe jo-akademik në nivel të përfaqësimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores me nr. prot. 771, datë 6.3.2020 për rregullat dhe procedurat për zgjedhjet e përgjithshme të personelit akademik dhe jo akademik në nivel të përfaqësimit në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe do të zbatohet për aq sa është e nevojshme për procedurat e zgjedhjeve, respektivisht procedurave përkritazi me zëvendësimin e mandateve respektive të personelit jo-akademik në nivel të përfaqësimit në Senatin e UP-së.

Neni 2

Paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 2 [Dispozitat e përgjithshme dhe shkurtesat] të rregullores bazike, riformulohen si në vijim:

2. Secila palë e pakënaqur lidhur me procedurat zgjedhore ka të drejtë ankese kundër vendimeve të nxjerra në kuptim të kësaj rregulloreje. Instancë e parë për shqyrtimin e ankesave janë Komisioni Zgjedhor i Fakultetit (për kandidatë nga fakultetet) dhe Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore (për kandidatë nga Administrata qendrore).
3. Ankesa kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit dhe Komisionit Zgjedhor të Administratës Qendrore, i parashtrohet Komisionit Qendror Zgjedhor. Vendimi i KQZ-së është përfundimtar.
4. Shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - UP - Universitetit i Prishtinës "Hasan Prishtina";
 - KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
 - KZF - Komisioni Zgjedhor i Fakultetit;

- KZAQ - Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore;
- KF - Këshilli i Fakultetit.

Neni 3

Neni 10 [Kandidimi për Këshillin e Fakultetit dhe për Senat] i rregullores bazike plotësohet me paragrafin 5, si në vijim:

5. Anëtarët e KZAQ-së, mund të zgjedhin, por nuk mund kandidojnë në zgjedhjet e personelit jo-akademik në nivel të përfaqësimit në Senatin e UP-së.

Neni 4

Paragrafi 2 i neni 13 [Listat e votuesve] të rregullores bazike, riformohet si në vijim:

2. Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga ndonjë Fakultet apo Administrata Qendrore e UP-së, ndaj personave përgjegjës do të inicohet procedura disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues të UP-së, pas njoftimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 5

Paragrafi 2 i nenit 14 [Përmbajtja e listës së votuesve] të rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

2. Lista e personelit të Administratës Qendrore me të drejtë vote do të përgatitet nga Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore (KZAQ).

Neni 6

Paragrafët 3 dhe 5 të nenit 16 [Përmbajtja e listës së kandidatëve] të rregullores bazike, riformulohen si në vijim:

3. Lista e kandidaturave të administratës qendrore për Senat do të përgatitet nga Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore (KZAQ).
5. Lista zyrtare e personelit që kandidohen, së paku një (1) ditë para zgjedhjeve do të publikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor në dekanatet e Fakulteteve, në AQ dhe në uebfaqen e fakulteteve dhe atë të UP-së.

Neni 7

Paragrafi 6 i nenit 17 [Komisioni Qendror Zgjedhor-KQZ] të rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

6. Për të gjitha rastet kur mandati në organet e UP-së, për personat e zgjedhur sipas kësaj rregulloreje përfundon para kohe, përbërja e njëjtë e KQZ-së, KZF-së dhe KZAQ-së, janë kompetente për zbatimin e procedurave përkritazi me zëvendësimin e mandatit respektiv.

Neni 8

Paragrafi 1 i nenit 18 [Ankesat] të rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

1. Anëtari i personelit ka të drejtë të ankohet kundër vendimeve të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit dhe Komisionit Zgjedhor të Administratës Qendrore, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Pas nenit 19 [Komisioni Zgjedhor i Fakultetit] të rregullores bazike, shtohet neni me numër rendor 19/A, me tekstin si në vijim:

Neni 19/A Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore

1. Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore përbëhet nga tre anëtarë:
 - 1.1. Dy drejtorë të zyrave në AQ;
 - 1.2. Një përfaqësues nga zyra ligjore;
2. Kryesuesi dhe zv. kryesuesi vijnë nga të emëruarit nga radhët e drejtorëve, ndërsa përfaqësuesi nga zyra ligjore kryen shërbimet e sekretarisë, administratës dhe shërbimet tjera juridike.
3. Zgjedhja e anëtarëve të KZAQ-së bëhet me shumicë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues të UP-së.
4. Nëse asnjë kandidat pas votimit të parë nuk ka marrë shumicën e votave, sipas paragrafit 2 të këtij neni, në votimin e dytë garojnë katër kandidatët që kanë marrë më së shumti vota dhe zgjedhen dy kandidatët me numrin më të madh të votave të fituara nga votimi i dytë për secilën prej pozitave të parapara në paragrafin 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij neni.
5. Procesverbalet e komisionit të zgjedhjeve hartohen dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZAQ-së.
6. Mbledhjet e komisionit thirren nga kryesuesi i KZAQ me pëlqimin e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 10

Paragrafi 3 i nenit 20 [Data e zgjedhjeve të përgjithshme] të rregullores bazike, riformulohet si në vijim:

3. Komisioni Qendror Zgjedhor në bashkërendim me KZF-të dhe KZAQ-në duhet të shpallin lokacionin e vendvotimeve.

Neni 11

Paragrafi 1 i nenit 21 [Mënyra e votimit] të rregullores bazike, riformulohet si në vijm:

1. Votuesit me të drejtë vote duhet që personalisht të hedhin votën në kutinë e votimit, në vendvotimet përkatëse.

Neni 12

Paragrafi 1 i nenit 22 [Mbikëqyrja e procesit zgjedhor] të rregullores bazike, riformulohet si në vijm:

1. Zgjedhjet duhet të mbahen nga komisionet zgjedhore të Fakulteteve dhe Komisioni zgjedhor i Administratës Qendrore, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 13

Neni 23 [Procedurat e votimit dhe fletëvotimet] i rregullores bazike plotësohet me paragrafin 3, si në vijim:

3. Komisioni Zgjedhor i Administratës Qendrore do të veprojë si në parag. 1 dhe 2 të këtij neni, për të siguruar mbarëvajtjen e rregullt të procedurave zgjedhore në AQ.

Neni 14


Paragrafi 3 i nenit 28 [Vlefshmëria dhe zbatimimi] të rregullores bazike, riformulohet si në vijm:

3. KQZ/KZF/KZaq, janë përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 15

Dispozitat përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore nuk i shfuqizon dispozitat (nenet) e prekura të rregullores e cila është objekt plotësimi përmes kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UP-së.
3. Kjo rregullore, pas miratimit publikohet në ueb faqen e UP-së dhe i dërgohet të gjitha KZF-ve dhe KZaq-së.


Këshilli Drejtues i UP-së
Dr. Arbëresha Neta-Turjaka, kryesuese